

AKT THEMELUES



I Shoqerise Tregtare Ben - Impex sh.p.k.

Une, Arben Petto , neneshtetas shqiptar , lindur me 21.02 1960 , banues ne Tirane , Rruga Myslym Shyri , Pal.6 , shk.5 , Ap.35 , ne baze te Ligjit nr.7638, date 19.II.1992 "Per shoqerite tregtare", themeloj nje shoqeri me kushtet e meposhteme:

Neni 1. Shoqeria Ben - Impex sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet e vepron ne baze te legjislacionit shqiptar.

Neni 2. Shoqeria e ka seline ne Tirane , Rruga Myslym Shyri , Pall. 6. shk.5 . Ap. 35.

Neni 3. Kohezgjatja e shoqerise fiksohet deri me 31-dhjetor 2020.

Neni 4. Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke , sipas vertetimit te Bankes bashkelidhur .

Neni 5. Shoqeria ka per objekt:

1. Blerjen, shitjen, eksportimin, importimin, tregtimin me pakice e me shumice te mallrave te ndryshme , veçanerisht materia ndertimi , qe kerkohen nga tregu shqiptar e i huaj.
2. Prodhimin, perpunimin, ambalazhimin , transportimin e mallrave te ndryshme per llogari te saj e te treteve .
3. Kryerjen e investimeve ne fushen e objektit te veprimtarise per llogari te saj e te treteve.
4. Kryerjen e sherbimeve te ndryshme per persona fizike e juridike , vendas e te huaj , sherbime doganore , spedicionere , ne fushen e tregut.
5. Bashkepunim me persona juridike vendas e te huaj ne drejtim te blerjes se aksioneve, marrjes pjese ne drejtimin e tyre dhe çdo lloj bashkepunimi me ta qe gjykohet e arsyeshme.



6. Operacione financiare si dhe çdo aktivitet tjetër për llogari të saj apo të tretëve që do të gjykohej i favorshëm dhe me lehtësi për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e shoqërisë.

Neni 6. Shoqëria administrohet nga Administratori i Përgjithshëm z. Arben Petto.

Neni 7. Rregulla me të hollësishtme për organizimin dhe drejtimin e shoqërisë gjenden në statut që është pjesë përbërëse e kësaj kontrate

Hartuar në katër kopje, më 08.05.1996

ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

Arben Petto

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTËSISE

NOTERIA TIRANE


NR. 311


NR. 55

VERTETIM

Sot me datën 08.05.1996 u prezantua në Noterine e Tiranës z. Arben Petto, si përpilues i dokumentave të shoqërisë Ben - Impex sh.p.k., i panjohur prej meje por për identitetin e tij u sigurova nga letërnjoftimi përkatës, madhor e me zotësi për të vepruar, i cili deklaroi se këto dokumenta i ka përpiluar jashtë kësaj zyre dhe me vullnetin e lirë të tij i firmosi para meje noteres.

NOTERE





STATUTI

I Shoqerise Tregtare Ben - Impex sh.p.k.

Neni 1 - Forma e Legjislacioni

Shoqeria Ben - Impex sh.p.k.(me poshte e quajtur shoqeria)eshte nje shoqeri tregtare private e regjistruar ne Republiken e Shqiperise ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas Ligjit nr.7638,date 19.II.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe qe e kryen aktivitetin e saj ekonomik sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 2 - Miratimi

Shoqeria fiton te drejtat e personit juridik nga data e marrjes se vendimit perkates nga ana e Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 3 - Selia

Selia e shoqerise eshte ne Tirane , Rruga Myslim Shyri , Pall. 6 , shk. 5 Ap. 35

Ajo mund te transferohet ne çfaredo vendi tjeter brenda qytetit te Tiranës ose ne ndonje qytet tjeter te Republikës se Shqiperise me vendim te Administratorit te Pergjithshem te shoqerise . Shoqeria mund te hape filiale,dege apo perfagesi te saj ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj te cilat do te krijohen ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ate te vendeve ku do te ngrihen.

Neni 4 - Kohezgjatja e veprimtarise

Kohezgjatja e shoqerise fiksohet deri ne 31-dhjetor 2020 dhe mund te zgjatet ose te zgjidhet para kohe me vendim te Administratorit te Pergjithshem.

Neni 5 - Objekti

Shoqeria ka per objekt:

- 1.Blerjen,shitjen,eksportimin,importimin,tregetin ,me pakice e me shumice, te mallrave te ndryshme , veçanerisht materia ndertimi , qe kerkohen nga tregu shqiptar e i huaj.
- 2.Prodhimin,perpunimin,amballazhimin , trasportimin e mallrave te ndryshme per llogari te saj e te treteve.
- 3.Kryerjen e investimeve ne fushen e objektit te veprimtarise per llogari te saj dhe te treteve.
- 4.Kryerjen e sherbimeve te ndryshme per persona fizike e juridike,vendas e te huaj, sherbime doganore , spedicionere , ne fushen e turizmit.



6. Bashkepunim me persona juridike, vendas e te huaj ne drejtim te blerjes se aksioneve, marrjes pjese ne drejtimin e tyre si dhe çdo forme bashkepunimi me ta qe gjykohet e arsyeshme

6. Operacione financiare si dhe çdo aktivitet tjeter per llogari te saj dhe te trefteve qe do te gjykohet i favorshem dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

Neni 6 - Kapitali themelor

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke i vendosur nga z.Arben Petto ortak i vetem i shoqerise,i ndare ne 100 kuota vlera nominale e te cilave eshte 1 000 leke.Kapitali themeltar i shoqerise ne asnje rast nuk duhet te jete me i vogel se shuma e permendur me lart ne kete nen.

Neni 7 - Kushte ekonomike

Ortaku i vetem i shoqerise Ben - Impex sh.p.k. perballon humbjet e saj vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themelor.

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen.

E ardhura bruto e shoqerise,pasi zbriten amortizimi i te gjithë pasurive te luajtshme e te paluajtshme, sipas niveleve te miratuara,kuotat qe kane te bejne me kredite per investime, pagat, shtesat mbi page dhe shpenzime te tjera qe lidhen me to,shpenzimet per lendet e para apo ndihmese,energjiine si dhe shpenzime te pergjitheshme te reparteve te shoqerise,ato prodhuese e jo prodhuese ,humbjet e vitit te meparshem dhe taksa mbi fitimin,merret nga ortaku i vetem i shoqerise.

Shoqeria gjithashtu nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar le menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve derisa ky fond te arrije 1/10 e kapitalit themelor.

Veprimtaria do te zhvillohet ne baze te parimeve ekonomike dhe do te pasqyrohet periodikisht ne bilancet dhe llogarite vjetore perkatese sipas legjislacionit te kontabilitetit ne fuqi.

Neni 8 - Trashegimia e transferimi

Kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashegimie.Ai eshte lirisht i transferueshem ne rast te ndarjes se pasurise midis bashkeshorteve,paraardhesve e pasardhesve. Ai gjithashtu eshte lirisht i transferueshem tek persona te trete me vendim te Administratorit.



Neni 9 - Kontrata e punes

Marredheniet e punes ne shoqeri, filial apo dege rregullohen ne baze te kontrates se punes qe lidhet midis punonjesit dhe drejtuesve te shoqerise. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar te punes.

Neni 10 - Administrimi

Shoqeria drejtohet nga pronari i saj z.Arben Petto qe eshte njekohesisht edhe ortak i vetem i shoqerise. Pronari eshte organi vendimor i shoqerise i cili ka gjithë kompetencat dhe fuqite per te marre vendimet perkatese ne lidhje me ndryshimet ne statut, shtimin apo pakesimin e kapitalit themelor, emerimin e administratoreve, te eksperteve kontabel, miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise, miratimin e struktures administrative dhe nivelin e pagave, zgjatjen ose pushimin e veprimtarise hapjen dhe mbylljen e filialeve si dhe çdo gje tjeter qe e gjykon te arsyshme .

Organi administrativ i shoqerise eshte Administratori i Pergjithshem i cili zgjidhet nga Pronari. Administratori i Pergjithshem organizon punen per zbatimin e planeve, administron pasurine e shoqerise, drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve, degeve perfaqesive, perfaqeson shoqerine para te treteve, ne gjykate e arbitrazhe, para administrates shtetere e organeve financiare, zbaton planet e programet e miratuara, neneshkruan kontrata apo marreveshje ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete, e merr te gjitha vendimet qe kane lidhje me administrimin e zakonshem te shoqerise e qe nuk jane ne kompetence te Pronarit. Administratori i pare i shoqerise eshte z. Arben Petto.

Neqoftese ne mbyllje te vitit financiar realizohen dy prej shifrave te përmendura ne nenin 65 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" Pronari emerone nje ekspert kontabel.

Neni 11 - Likujdimi

Aktiviteti i shoqerise mund te pushoje ne rastin e parashikuar ne nenin 4 te ketij statuti ose ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.

Shoqeria mund te mbyllet ne formen e riorganizimit ose te likujdimit. Ne rastin e likujdimit , Pronari emerone nje likujdator i cili vepron ne baze te dispozitave perkatese ne fuqi.



Neni 12 - Referimi ne ligj

Persa nuk eshte parashikuar ne statut i referohet ligjit perkates ne fuqi

Hartuar ne kater kopje, me 08.04.1996

ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM

Arben Petto

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA TIRANE

NR. 312

NR. 56

VERTETIM

Sot me daten 8.04.1996 u prezantua ne Noterine e Tiranës zoti Arben Petto, si perpilues i dokumentave te shoqerise Ben-impex, i panjohur prej meje por per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi perkates, madhor e me zotesi per te vepruar. Ai deklaroi se kete kerkese e ka perpiluar jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij te lire firmosi para meje, Noteres.

